# DËSHMI ARKIVI

**A-469618**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "'Ripërtëritja' e PD është jetike për vendin", Berisha nga Elbasani: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/riperteritja-e-pd-eshte-jetike-per-vendin-berisha-nga-elbasani-shqiperia-ngjan-me-nje-te-semure-ne-urgjence-kerkon-nderhyrje/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 16:51:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 16:50:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 16:49:00 UTC → 25 shtator 2026, 16:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8d7ca7d444c86b24f7c36b8f6dc7297ddfd65c3782daf24221b9a0c78037da76` |
| TEKSTI | `37f7e840d3fe8b22748315424a4bcdbc1c1cad91bd7d5fd98b95d5c9ffc9abbd` |
| PAMJA | `94bf5c6e869168073050bd02bad05c6a0be63d89f1adfab04ff0e086342467af` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2babc2f4f442a8e61a9f7e6ab86a27f12d0b9b7e47952368ec27736093343a23` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2babc2f4f442a8e61a9f7e6ab86a27f12d0b9b7e47952368ec27736093343a23`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKË TË FUNDIT

# "'Ripërtëritja' e PD është jetike për vendin", Berisha nga Elbasani: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje

25/09/2026 18:50




**Sali Berisha zhvilloi sot në Elbasan një takim me strukturat dhe mbështetësit e Partisë Demokratike, ku në fjalën e tij hodhi akuza të forta ndaj qeverisjes së Edi Ramës, duke e lidhur situatën ekonomike dhe sociale në vend me korrupsionin, krimin e organizuar dhe emigracionin.**

Në vijim të fjalës së tij në Elbasan, Sali Berisha u ndal te pensionet, kostot e rritjes së fëmijëve dhe çmimet e qirave, duke i renditur këto si disa prej faktorëve që, sipas tij, po nxisin largimin e shqiptarëve nga vendi.

Berisha deklaroi se mbi 600 mijë pensionistë marrin pensione të pjesshme dhe se të ardhurat e tyre nuk mjaftojnë për të përballuar nevojat bazë.

Ai tha gjithashtu se kostoja e rritjes së një fëmije në vitin e parë arrin në 66% të pagës, ndërsa qiratë, sipas tij, janë afruar me nivelin e pagës mesatare.

Në këtë kuadër, kreu i PD-së e krahasoi situatën në vend me një pacient në urgjencë dhe e cilësoi ripërtëritjen e Partisë Demokratike si të domosdoshme për atë që ai e quan "ripërtëritjen e Shqipërisë", duke bërë thirrje për mobilizim drejt fitores së opozitës.

"Sot, jo vetëm ilaçet, por mbi 600 mijë pensionistë janë me pensione të pjesshme. Janë me pensione me të cilat absolutisht nuk marrin dot as dy javë ushqime, pa le ndihmë nga familjarët e tyre.

Këto ditë publikohet lajmi se për të rritur një fëmijë, foshnja në vitin e parë, kërkon 66% të rrogës. Prandaj dhe ne jemi, kemi rënë në këtë mënyrë. Qiratë kanë kapur nivelin e rrogës mesatare. Pra, janë bërë mollë e ndaluar apartamentet për qytetarët.

Të gjithë këta faktorë shtyjnë qytetarët tanë të ikin, të ikin, të ikin. Ndërkohë, vendi është absolutisht vendi i pasurive përrallore. I pasurive përrallore të gjithanshme. Nuk ka tokë dhe vend më të begatë se Shqipëria në çdo aspekt. Por të gjitha këto janë shndërruar në një mënyrë apo në një tjetër, në mallkim për qytetarin shqiptar.

Janë shndërruar në parajsë për qeveritarë të pangopur dhe hajdutë, të cilët në mënyrë identike me ata që shtypën shqiptarët 46 vite, urrejnë qytetarin. Mund të listojmë një listë të pafundme të problemeve të jashtëzakonshme të rënda që përballet qytetari, për shëndetin e tij, për shkollimin e fëmijëve.

U ndala në këtë paraqitje për të theksuar se sirenat e nevojës për rithemelimit të Shqipërisë bien në të katër anët e vendit. Shqipëria realisht ngjet me një të sëmurë në sallën e urgjencës.
Ngjet me një të sëmurë në sallën e urgjencës i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme.


## Kryesore



U sulmua me vezë në Nju York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se...
16:46

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Shiu nuk do zgjasë! Fundjava me diell dhe temperatura vjeshte deri në 27-28 gradë celsius
12:33

FOTO/ Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, taksia përplaset me autobusin me mësues, plagosen tre persona
15:18

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

"Bëra gabim që qëllova me shishe"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin

Atentati në Sarandë, TCh siguron videon ekskluzive/ Ja momenti kur ekzekutohet "Tani i Ruzhdiut"

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

"Më goditi me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisariatit të Krujës për videon virale ku u përfshi

Ndaj dhe ripërtëritja e Partisë Demokratike është jetike dhe përcaktuese për ripërtëritjen e Shqipërisë.

Ju them unë ju, keni meritë të jashtëzakonshme, sepse në kushtet më të vështira i qëndruat opozitarë. I qëndruat dhëmbë për dhëmbë këtij regjimi. I qëndruat të pamposhtur pavarësisht nga të gjitha, nga dhuna, terrori, burgosjet, shantazhet, presionet e të tjerë, të gjithë makinerinë e tij.

Pa ju, pa qëndresën tuaj, pa guximin tuaj, ky regjim nuk ishte i shpërbërë në të sotmen. Jo. Pra, në këtë kuadër, fitorja jonë është një domosdoshmëri. Jo për t'u kthyer shpinën, jo për t'i injoruar ata qëndrestarë që për mua janë heronj, heronj të vërtetë. Por për të përshkruar kilometrin e fundit drejt fitores.

Për të ecur drejt fitores. Për të ecur drejt fitores. Demokratët, populli opozitar pret fitoren. Shqipëria pret me padurim fitoren e opozitës. Dhe kjo është përgjegjësi e madhe ndaj vendit.
Ky është motivi i jashtëzakonshëm për ne", tha ai.

**Top Channel**

Akuzonet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj

U sulmua me vezë në Nju York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se...

Ekskluzive/ Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, Top Channel mëson se kur i dorëzon letrat kredenciale Presidenti Begaj

## Politikë »



Ekskluzive/ Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, Top Channel mëson se kur i dorëzon letrat kredenciale Presidenti Begaj
25/09 17:56



U sulmua me vezë në Nju York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se...
25/09 16:46



"Kemi kaluar epokën ku shiheshim si poshtërimi i Europës", Rama nga Nju Jorku: S'duhet të kemi frikë nga investimet e huaja, Shqipëria është dhe për miqtë
25/09 16:36



"Na sulmojnë përmes medias sociale"/ Kryeministri Rama: Nuk jam avokat për t'i mbyllur ato, e vërteta nuk ka qenë kurrë kaq e shpërfillur
25/09 16:30



Ndryshime në kabinet/ Oltjon Muzaka largohet nga Ministria e Shëndetësisë, emërohet zëvendësministër i Brendshëm
25/09 16:15



"Kemi aeroportin më të madh në rajon"/ Rama në New York: Më shumë udhëtarë se në Beograd, ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu
25/09 16:13

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Në prag të ndeshjes me Bjellorusinë/ Maran- Skuadër e fortë dhe kompakte, kemi respekt



Top News- 'Zbaton verbërisht urdhrat e Kurtit'/ Prag zgjedhjesh, Vuçiç akuza ministrit Rashiç



Top News – I dërguari i Trump nis misionin. Ambasadori Eric Wendt zbarkon në Shqipëri







Top Channel/ “Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin”, Rama nga SHBA: Na sulmojnë…

Top News – Këshilltarët kërkojnë Veliajn. Diskutimet për territorialen, letër SPAK dhe burgjeve

Pamjet ekskluzive mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.